

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit: “Studim-projektim për 2 objektet e ndërtimit në Bashkinë Tiranë”, të ndarë në lote si më poshtë vijon:

- **Loti i I-rë: Studim-Projektim për objektin: “Ndërtim shkollë e Mesme (Tip 4), Njësia Strukturore TR/228, rruga “Stavri Themeli”;**
- **Loti i II-të: Studim-Projektim për objektin: “Rikonstruksion Shkolla 9-Vjeçare “17 Shkurti” dhe ndërtim palestre”;**

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit: (CPV): 71000000-8 (Shërbime arkitektonike, inxhinierike, ndërtimi dhe inspektimi)

Vlera e fondit limit : **12,305,100.99** (dymbëdhjetë milion e treqind e pesë mijë e njëqind pikë nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, e ndarë në lote si më poshtë:

- **Loti i I-rë:** Studim-Projektim për objektin: “Ndërtim shkollë e Mesme (Tip 4), Njësia Strukturore TR/228, rruga “Stavri Themeli”, me fond limit: **8,048,310.74** (tetë milion e dyzet e tetë mijë e treqind e dhjetë pikë shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.
- **Loti i II-të:** Studim-Projektim për objektin: “Rikonstruksion Shkolla 9-Vjeçare “17 Shkurti” dhe ndërtim palestre”, me fond limit: **4,256,790.25** (katër milion e dyqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë pikë njëzet e pesë) lekë pa TVSH.

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Nenit 2, pika 2/c si dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Loti i I-rë: Studim-Projektim për objektin: “Ndërtim shkollë e Mesme (Tip 4), Njësia Strukturore TR/228, rruga “Stavri Themeli”:

1. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3 ;

Argumentimi: Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe në VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26. Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Sipas Shtojcës 9 të DST (kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- a. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuara të balanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (**2023, 2024, 2025**) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Shëmin: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “b” të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 date 05.03.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

- b. Kopje të deklaramentit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (**2023, 2024, 2025**) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros **për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar** duhet të jetë jo më e vogël se vme e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën

- c. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 dhe këstin përkatës të vitit 2026 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Argumentimi Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë jo më e vogël se **40%** e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuara gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
 - a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e shërbimeve të ngjashme në studim projekte/ projekte, formularin e vlerësimit për realizimin e shërbimeve të ngjashme në studim projekte/ projekte dhe faturat tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat si dhe objekti i shërbimeve të ngjashme në studim projekte/ projekte.
 - b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e shërbimeve të ngjashme në studim projekte/ projekte, formular vlerësimi/vërtetim për realizimin e shërbimeve të ngjashme në studim projekte/ projekte ku të shënohet vlera, afati i kontratës dhe objekti i shërbimeve të ngjashme në studim projekte/ projekte, të realizuar si dhe faturat tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat si dhe objekti i shërbimeve të ngjashme në studim projekte/ projekte të realizuar.
 - c) Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën e bashkimit të operatorëve të deklaruara në fazën e tenderimit.
 - d) Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën bazë ndërmjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor, kontratën e nënkontraktimit dhe aktin e miratimit zyrtar si nënkontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Duke qenë se kjo procedure prokurimi do të konkludojë me një kontratë studim projektimi për të deshmuar përvojën e mëparshme vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë: **Liçensa profesionale** të operatorit ekonomik **(e vlefshme) për projektim** (lëshuar nga MZHUT ose nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim), ku të përfshihen kategorite:

2. PROJEKTUES ARKITEKT

- b-2- Projektim qendra tregtare; objekte social kulturore; objekte kulti; objekte arsimore.
- d- Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbra, lulishte e parqe.

3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

- a- Objekte civile - industriale - turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.

4. PROJEKTUES INSTALATOR

- a- Projektim të instalimeve hidro-termosanitare.
- b- Projektim të instalimeve termoteknike-kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme.
- c- Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.
- f- Projektim të sistemeve kundra zjarrit.
- h- Projektimi i impianteve ngritëse e transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse etj.).
- j- Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industriale.

5. PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE

- b- Furnizim me ujë - kolektorë shkarkimi.
- c- Ujësjellës-kanalizime urbane - rurale.

8. PROJEKTUES GJEODET

- a- Rivetime inxhinierike.

9. STUDIM GJEOLIGO-INXHINIERIK - HIDROGJEOLOGJIK

- a- Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile - ekonomike deri 5 kate.

12. STUDIME TË SIZMOLOGJISË INXHINIERIKE (vetëm për shoqëri/persona juridikë)

- b- Studime/vlerësime gjeologo-sizmike për trojet ku ndërtohen objektet civile, sociale e kulturore

Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë

veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë **Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (leshuar nga MZHUT** ose institucione të tjera të autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e liçensave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë liçencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente. Licensat e mësipërme janë vendosur në kuadër të natyrës së përgjithshme të punimeve që priten të realizohen në këtë procedurë.

Po paraqesim argumentimet si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pikat e kategorise	Pershkrimi per kategorite
Projektues Arkitekt	b-2- Projektim qendra tregtare; objekte social kulturore; objekte kulti; objekte arsimore.	<i>Projektim arkitektonik për ndërtimin e objektit të shkollës, përfshirë organizimin e ambienteve mësimore, administrative, sportive, sanitare dhe shërbyese dhe përshtatjen e tyre me kërkesat funksionale të objektit arsimor duke pasur parasysh aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuar.</i>
	d - Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbra, lulishte e parqe.	<i>Projektim i sistemimit të jashtëm dhe peisazhit, përfshirë sipërfaqet e gjelbërta, hapsirat e rekreacionit dhe organizimin e ambienteve të jashtme.</i>
Projektues Konstruktore	a - Projektim objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.	<i>Projektim konstruktiv i objektit , përfshirë strukturën mbajtëse, themeleve, elementeve prej betony të armuar dhe cdo elementi tjetër konstruktiv.</i>
Projektues Instalator	a - Projektim të instalimeve hidro-termosanitare.	<i>Projektim i instalimeve hidro-termosanitare të objektit, përfshirë furnizimin me ujë, instalimet sanitare dhe shakrkimn e ujrave të ndotur</i>
	b - Projektim të instalimeve termoteknike-kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme.	<i>Projektimi i instalimeve termoteknike dhe të kondicionimit përfshirë sistemet e ngrohjes, ftohjes dhe ventilimit.</i>

	c - Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.	<i>Projektim i instalimeve dhe linjave elektrike, përfshirë furnizimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, ndricimin e ambienteve, ndricimin e emergjencës dhe sigurisë si dhe instalimet elektrike të nevojshme.</i>
	f - Projektim të sistemeve kundra zjarrit.	<i>Projektim i sistemeve të mbrojtjes nga zjarri, përfshirë sistemet e sinjalizimit, mbrojtjes dhe masat e nevojshme teknike për garantimin e sigurisë.</i>
	h- Projektimi i impianteve ngritëse e transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse etj.)	<i>Projektimi i impianteve ngritëse dhe transportuese në funksion të aksesueshmëris dhe përdorimit të objektit nga nxënësit duke pasur parasysh personat me aftësi të kufizuara.</i>
	j - Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industriale.	<i>Projektim i rrjeteve të telefonisë, internetit dhe transmetimit të të dhënave, CCTV, alarmit dhe sistemeve të tjera të sigurisë.</i>
Projektues i Veprave Hidraulike	b - Furnizim me ujë - kolektorë shkarkimi.	<i>Projektim i sistemit të furnizimit me ujë dhe kolektorëve të shkarkimit përfshirë lidhjet me rrjetet përkatëse.</i>
	c - Ujësjellës-kanalizime urbane - rurale.	<i>Projektimi i rrjeteve të ujësjellësit dhe kanalizimeve për furnizimin dhe shkarkimin , përfshirë lidhjet me rrjetin egzistues dhe sistemin e rrjetit të objektit që do të ndërtohet.</i>
Projektues Gjeodet	a- Rivelimet inxhinierike.	<i>Realizimi i rilevimit topografik të territorit , përcaktimi e gjendjes egzistuese, kuotave, kufijve të territorit në funksion të hartimit të objektit.</i>
Studim gjeologo-inxhinierik - hidrogeologjik	a-Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile - ekonomike deri 5 kate.	<i>Studim gjeologjik-inxhinierik dhe hidrologjik të truallit të ndërtimit, për përcaktimin e karakteristikave të terrenit dhe kushteve gjeologjike, në funksion të projektimit të themeleve dhe strukturës së objektit.</i>
Studime të sizmologjisë inxhinierike	b- Studime/vlerësime gjeologo-sizmike për trojet ku ndërtohen objektet civile, sociale e kulturore	<i>Studim dhe vlerësim sizmologjik i truallit të ndërtimit për përcaktimin e parametrave sizmikë të nevojshëm për projektimin e strukturave mbajtëse.</i>

- Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha shërbimeve të projektimit, të përfshirë në licensën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar, si më poshtë:

- 1 (një) Arkitekt;
- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi (Profili strukturë);
- 1 (një) Inxhinier Mekanik;
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik;
- 1 (një) Inxhinier Elektrik;
- 1 (një) Inxhinier gjeodet;

Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

Stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

Per stafin e mësipërm, operatori ekonomik duhet të deklarojë emër/mbiemër, profili i punës, numër dhe datë kontrate të punës, diploma përkatëse si dhe institucioni që ka lëshuar dokumentin. Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njesia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar Termave të përgjithshme të references për objektet pjesë e kësaj procedure, pjesë e secilave do të jenë të licensuar për shërbimet që priten të realizohen. Pika e licenses me sipër perkojnë perkatesisht me stafin drejtues teknik për realizimin e procedures.

4.Operatori ofertues duhet të ketë si pjesë të stafit të tij / mbështetës të shoqërisë, stafin teknik si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier gjeolog/gjeoteknik *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, të paktën njëri nga operatorët duhet të ketë pjesë të stafit të tij Inxhinier gjeolog/gjeoteknik);*
- 1 (një) punonjës specialist “Ekspert Zjarrëfikës në fushën e mbrojtjes nga Zjarri dhe për shpëtim” në përputhje me Ligjin Nr.152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/certifikatë dhënë nga Drejtoria MZSH.*(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, të paktën njëri nga operatorët duhet të ketë pjesë të stafit të tij një specialist në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin);*

a) Për stafin e mësipërm Operatori ofertues duhet të paraqesë:

- Kontratat individuale të punës (të vlefshme)
- Diplomë / Çertifikatë (e vlefshme)

b) Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme”, operatorët pjesëmarrës si dhe operatorët mbështetës të deklaruar nga operatorët pjesëmarrës si subjekt mbështetës duhet të deklarojnë për stafin e kërkuar sipas pikës 2.3.4 të dhënat si më poshtë:

- Emër / Mbiemër
- Profilin e punës

- Numrin dhe datën e kontratës individuale të punës
- Numrin dhe titullin e kualifikimit për diplomën / certifikatën përkatëse si dhe institucionin që ka lëshuar dokumentin

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njesia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar Termave të referencës, natyrës së përgjithshme të shërbimeve që priten të ofrohen. Prezenca e stafit të mesipër është gjykuar si e domosdoshme dhe e nevojshme për një shpërndarje dhe efikasitet sa më të madh në realizimin e shërbimeve konkretisht;

1 (një) Eksperti zjarrfikës është i domosdoshëm të jetë prezent gjatë hartimit të projekteve të mbrojtjes ndaj zjarrit dhe vlerësimeve përkatëse të fushës bazuar në terma të referencës.

5. Operatori ekonomik duhet paraqesë me anë të një deklaratë listën e personelit kryesor të nevojshëm për të zbatuar objektin dhe CV të shoqërisë për punët e realizuara gjatë aktivitetit të saj.

6. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të paktën **8 (tetë)** punonjës të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për minimumi 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për minimumi 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar.

b) Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërket nga legjislacioni në fuqi për minimumi 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë: për përcaktimin e fuqisë punëtore minimale të kërkuar argumentojmë se jemi bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Detyrës së Projektimit. *Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë, tregon besueshmëri për autoritetin. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Numri I mesipër perkon me stafin që pritet të jetë I angazhuar në keto procedura.*

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

a) Certifikatën e menaxhimit të cilësisë SSH/DIN/CEI/EN/UNI ISO 9001:2015 (e vlefshme) ose ekuivalente, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të

njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën SSH/DIN/CEI/EN/UNI/ISO 9001:2015 ose ekuivalente.

- b) Çertifikatën e menaxhimit të energjisë SSH/DIN/CEI/EN/UNI ISO 50001-2018 (e vlefshme) ose ekuivalente, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën SSH/DIN/CEI/EN/UNI/ISO 50001-2018 ose ekuivalente.

Argumentimi: *Kerkesat e mesiperme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", sipas të cilit: "Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë", si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", ku përcaktohet se: "Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit" Çertifikatat e cilësisë janë në përputhje me natyrën dhe objektin e kontratës që prokurohet.*

Shënim: *Kandidati ofertues në përlllogaritjen e ofertës duhet të referohet njoftimit të bërë me Nr.5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim"*

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ku parashikohet: "Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla", si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, sjellim në vëmendje se:

-Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojnë formularin e ofertës sipas kërkesave të përcaktuara në shtojcën 1, pjesë e këtyre dokumenteve të tenderit.

- Gjithashtu operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojnë edhe listën e çmimeve të shërbimeve i cili është vënë në dispozicion nga autoriteti kontraktor, pjesë e këtyre dokumenteve të tenderit.

- Dokumentet përkatëse vërtetuese për disponimin e punonjësve do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fitesit do t'i kërkojë ofertuesit të kualifikuar nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e

tjera të paraqitura ne sistemin elektronik të prokurimit gjate fazës së ofertimit. Mosparaqitja e dokumentacionit të sipërcituar do te jete kusht s'kualifikimi.

- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimet e bëra në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht s'kualifikimi.

Detyra e Projektimit dhe kërkesat funksionale janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur për hartimin e termave të referencave, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (I ndryshuar), për përmbushjen e qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen nga Autoriteti Kontraktor.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Loti i II-të: Studim-Projektim për objektin: “Rikonstruksion Shkolla 9-Vjeçare “17 Shkurti” dhe ndërtim palestre”;

1. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe në VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26. Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Sipas Shtojcës 9 të DST (kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- a. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuara të balanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (**2023, 2024, 2025**) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe te shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit

Kontabel te Autorizuar. Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “b” të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 date 05.03.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar.

- b. Kopje të deklaratimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (**2023, 2024, 2025**) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros **për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar** duhet të jetë jo më e vogël se me e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën

- c. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 dhe kështu përkatës të vitit 2026 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Argumentimi Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, nën 3.1/a, b, c dhe nën 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuara gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
 - a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e shërbimeve të ngjashme në studim projekte/ projekte, formularin e vlerësimit për realizimin e shërbimeve të ngjashme në studim projekte/ projekte dhe faturat tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat si dhe objekti i shërbimeve të ngjashme në studim projekte/ projekte.
 - b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e shërbimeve të ngjashme në studim projekte/ projekte, formular vlerësimi/vërtetim për realizimin e shërbimeve të ngjashme në studim projekte/ projekte ku të shënohet vlera, afati i kontratës dhe objekti i shërbimeve të ngjashme në studim projekte/ projekte, të realizuar si dhe faturat tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat si dhe objekti i shërbimeve të ngjashme në studim projekte/ projekte të realizuar.
 - e) Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën e bashkimit të operatorëve të deklaruara në fazën e tenderimit.
 - f) Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën bazë ndërmjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor, kontratën e nënkontraktimit dhe aktin e miratimit zyrtar si nënkontraktor.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Duke qenë se kjo procedurë prokurimi do të konkludojë me një kontratë studim projektimi për të deshmuar përvojën e mëparshme vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë: **Liçensa profesionale** të operatorit ekonomik **(e vlefshme) për projektim** (lëshuar nga MZHUT ose nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim), ku të përfshihen kategoritë:

2. PROJEKTUES ARKITEKT

- b-2- Projektim qendra tregtare; objekte social kulturore; objekte kulti; objekte arsimore.
- d- Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbra, lulishte e parqe.

3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

- a- Objekte civile - industriale - turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.

4. PROJEKTUES INSTALATOR

- a- Projektim të instalimeve hidro-termosanitare.

- b- Projektim të instalimeve termoteknike-kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme.
- c- Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.
- f- Projektim të sistemeve kundra zjarrit.
- j- Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industriale.

5. PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE

- b- Furnizim me ujë - kolektorë shkarkimi.
- c- Ujësjellës-kanalizime urbane - rurale.

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë **Licensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga MZHUT ose institucione të tjera të autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.***

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente. Licensat e mësipërme janë vendosur në kuadër të natyrës së përgjithshme të punimeve që priten të realizohen në këtë procedurë.

Po paraqesim argumentimet si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pikat e kategorise	Pershkrimi per kategorite
Projektues Arkitekt	b-2- Projektim qendra tregtare; objekte social kulturore; objekte kulti; objekte arsimore.	<i>Rikonstrukcion i fasadave, mureve te brendshme dhe te jashtme, kalimet emergjences, shkallet, korridoret, ambientet sanitare etj.</i>

	d - Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbra, lulishte e parqe.	<i>Rikonstruksion i sistemimit të jashtëm dhe peisazhit, përfshirë sistemimin e terreneve të jashtme sportive dhe sistemimin e oborrit të shkollës dhe ambienteve të gjelbërta.</i>
Projektues Konstruktore	a - Projektim objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.	<i>Rikonstruksion konstruktiv i objektit , ku parashikohet rikonstruksioni i tarracës, perforcimi/riparimi i muraturës mbajtëse, suvatimi i obejktit,izolimi i dysHEMEVE etj.</i>
Projektues Instalator	a - Projektim të instalimeve hidro-termosanitare.	<i>Rikonstruksion i instalimeve hidro-termosanitare të objektit, përfshirë furnizimin me ujë, instalimet sanitare dhe shakrkimn e ujrave të ndotur .</i>
	b - Projektim të instalimeve termoteknike-kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme.	<i>Rikonstruksion i instalimeve termoteknike dhe të kondicionimit përfshirë sistemet e ngrohjes, ftohjes dhe ventilimit.</i>
	c - Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.	<i>Rikonstruksion i instalimeve dhe linjave elektrike, përfshirë furnizimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, ndricimin e ambienteve, ndricimin e emergjencës dhe sigurisë si dhe instalimet elektrike të nevojshme.</i>
	f - Projektim të sistemeve kundra zjarrit.	<i>Rikonstruksion i sistemeve të mbrojtjes nga zjarri, përfshirë sistemet e sinjalizimit, mbrojtjes dhe masat e nevojshme teknike per garantimin e sigurisë.</i>
	j - Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industriale.	<i>Rikonstruksion i rrjeteve të telefonisë, internetit dhe transmetimit të të dhënave, CCTV,alarmit dhe sistemeve të tjera të sigurisë.</i>
Projektues i Veprave Hidraulike	b - Furnizim me ujë - kolektorë shkarkimi.	<i>Rikonstruksion i sistemit të furnizimit me ujë dhe kolektorëve të shkarkimit përfshirë lidhjet me rrjetet përkatëse.</i>
	c - Ujësjellës-kanalizime urbane - rurale.	<i>Rikonstruksion i rrjeteve të ujësjellësit dhe kanalizimeve për furnizimin dhe shkarkimin , perfshirë lidhjet me rrjetin egzistues dhe sistemimin e rrjetit të objektit qe do të ndërtohet.</i>

3. Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha shërbimeve të projektimit, të përfshirë në licensen e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë ne listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 muajit e fundit te deklaruar, si më poshtë:

-1 (një) Arkitekt;

- 1 (një) Inxhinier Ndertimi (Profili strukture);
- 1 (një) Inxhinier Mekanik;
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik;
- 1 (një) Inxhinier Elektrik;

Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

Stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

Per stafin e mësipërm, operatori ekonomik duhet të deklarojë emër/mbiemër, profili i punës, numër dhe datë kontrate të punës, diploma përkatëse si dhe institucioni që ka lëshuar dokumentin. Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njesia e prokurimit per vendosjen e stafit i eshte referuar Termave te pergjithshme te references per objektet pjese e kesaj procedure, pjese e secilave do te jene te licensuar per sherbimet qe priten te realizohen. Pika e licenses me siper perkojne perkatesisht me stafin drejtues teknik per realizimin e procedures.

4.Operatori ofertues duhet të ketë si pjesë të stafit të tij / mbështetes të shoqërisë, stafin teknik si më poshtë:

- 1 (nje) punonjës specialist “Ekspert Zjarrefikes ne fushen e mbrojtjes nga Zjarri dhe per shpetim” në përputhje me Ligjin Nr.152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin”, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certificate dhene nga Drejtoria MZSH.

(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, të paktën njëri nga operatorët duhet të ketë pjesë të stafit të tij një specialist ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin);

a) Për stafin e mësipërm Operatori ofertues duhet të paraqesë:

- Kontratat individuale të punës (të vlefshme)
- Diplomë / Çertifikatë (e vlefshme)

b) Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme”, operatorët pjesëmarrës si dhe operatorët mbështetës të deklaruar nga operatorët pjesëmarrës si subjekt mbështetës duhet të deklarojnë për stafin e kërkuar sipas pikës 2.3.4 të dhënat si më poshtë:

- Emër / Mbiemër
- Profilin e punës
- Numrin dhe datën e kontratës individuale të punës
- Numrin dhe titullin e kualifikimit për diplomën / çertifikatën përkatëse si dhe institucionin që ka lëshuar dokumentin

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin

e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njesia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar Termave të referencës, natyres së pergjithshme të shërbimeve që priten të ofrohen. Prezenca e stafit të mesipër është gjykuar si e domosdoshme dhe e nevojshme për një shpërndarje dhe efikasitet sa më të madh në realizimin e shërbimeve konkretisht;

1 (një) Eksperti zjarrfikës është i domosdoshëm të jete prezent gjatë hartimit të projekteve të mbrojtjes ndaj zjarrit dhe vlerësimeve përkatëse të fushës bazuar në terma të referencës.

5. Operatori ekonomik duhet paraqesë me anë të një deklaratë listën e personelit kryesor të nevojshëm për të zbatuar objektin dhe CV të shoqërisë për punët e realizuara gjatë aktivitetit të saj.

6. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të paktën 7 (shtatë) punonjës të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për minimumi 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për minimumi 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar.

b) Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërket nga legjislacioni në fuqi për minimumi 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i përcaktuar i punonjësve është përlogaritur si më poshtë: për përcaktimin e fuqisë punëtore minimale të kerkuar argumentojmë se jemi bazuar në shërbimet e kerkuara sipas Detyres së Projektimit. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë, tregon besueshmëri për autoritetin. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Numri i mesipër perkon me stafin që pritet të jete i angazhuar në keto procedura.

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë SSH/DIN/CEI/EN/UNI ISO 9001:2015 (e vlefshme) ose ekuivalente, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën SSH/DIN/CEI/EN/UNI/ISO 9001:2015 ose ekuivalente.

- b) Çertifikatën e menaxhimit të energjise SSH/DIN/CEI/EN/UNI ISO 50001-2018 (e vlefshme) ose ekuivalente, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën SSH/DIN/CEI/EN/UNI/ISO 50001-2018 ose ekuivalente.

Argumentimi: Kërkesat e mesiperme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Per prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit” Çertifikatat e cilësisë janë në përputhje me natyrën dhe objektin e kontratës që prokurohet.

Shënim: Kandidati ofertues në përlllogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr.5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik “Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, sjellim në vëmendje se:

-Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojnë formularin e ofertës sipas kërkesave të përcaktuara në shtojcën 1, pjesë e këtyre dokumenteve të tenderit.

- Gjithashtu operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojnë edhe listën e çmimeve të shërbimeve i cili është vënë në dispozicion nga autoriteti kontraktor, pjesë e këtyre dokumenteve të tenderit.

- Dokumentet përkatëse vërtetuese për disponimin e punonjësve do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit do t’i kërkojë ofertuesit të kualifikuar nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të paraqitura në sistemin elektronik të prokurimit gjatë fazës së ofertimit. Mosparaqitja e dokumentacionit të sipërcituar do të jete kusht s’kualifikimi.

- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimet e bëra në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Konstatimi i

mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorezuar përben kusht s'kualifikimi.

Detyra e Projektimit dhe kërkesat funksionale janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur për hartimin e termave të referencave, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (I ndryshuar), për përmbushjen e qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen nga Autoriteti Kontraktor.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.